Kronikë

I fiksuar pas gjuetisë së derrave të egër e sorkadheve, policia sekuestroi snajper, automatikë e pistoleta te 'i forti i Kukësit'

Gjatë operacionit të zhvilluar mes datave 16 dhe 17 nëntor 2023 uniformat blu kanë uhdtruar kontrolle në disa banesa, ndërsa njoftuan se kanë sekuestruar para e armë. Një pjesë e armëve janë sekuestruar në bazat e veprimit të Bujar Germizit në Kukës.

Bujar Germizi

Redaksia
25 Nëntor, 22:39 | **Përditësimi: 25 Nëntor, 22:52**

Share

Zbërthimet e SKY ECC çuan në goditjen e një grupi, ku ra në pranga ish-zv.drejtori i Policisë së Tiranës, Erzen Breçani, shefi i Krimeve Dedan Gjoni, si edhe Besmir Mustafi dhe Bujar Germizi. Ky i fundit njihet ndryshe edhe i si 'forti' i Kukësit. Gjatë operacionit të zhvilluar mes datave 16 dhe 17 nëntor 2023 uniformat blu kanë uhdtruar kontrolle në disa banesa, ndërsa njoftuan se kanë sekuestruar para e armë.

Ora News shkruan se një pjesë e armëve janë sekuestruar në bazat e veprimit të Bujar Germizit në Kukës. Atij i janë gjetur pistoleta, armë automatike dhe snajper.

LEXO EDHE:
PD replikon me Berishën: Pse e mohon Erzen Breçanin? A kishte gisht ai në sulmin e 8 janarit?

Gjatë momentit të arrestimit Germizi ka pretenduar se armët i mban për gjah. Gërmizi është i fiksuar për vrasjen e derrave të egër dhe sorkadheve në mal. Për shkak të lidhjeve të tij dhe me policinë private "ORKA" ai kishte siguruar disa armatime të fuqishme dhe precizon të lartë, duke realizuar vrasjen e derrave dhe sorkadheve nga një distancë e largët.

Të gjitha armët tashmë do i nënshtrohen ekspertimit balistik pas dyshimeve se mund të jenë përdorur në ngjarjet kriminale apo të jenë trafikuar nga Kosove dhe Maqedonia e Veriut.

Bujar Ajeti alias Germizi, ka precedentë të mëparshëm të trafikut të armëve, pasi në vitin 2008 u arrestua së bashku me tre persona të tjerë si pjesë e një grupimi që futi nga Kosova në Shqipëri, 100 pistoleta "Mini Bloë". Po ashtu dyshohet se Germizi ka qenë i përfshirë në një ***ngjarje të rëndë në Kukës*** më 1999. Sipas gazetarit Ferdinand Dervishi ai ka organizuar grabitjen e bankës ku punonte në Kukës. Madje e plagosi policia, por arriti të arratisej me 80 mln lekë.

Në dosjen e SPAK, Germizi akuzohet se në bashkëpunim me Mustafin dhe shefin e Krimeve Gjoni ka planifikuar ***vrasjen e dy vëllezërve*** që jetojnë në Britani të Madhe. Ata kanë dashur të vrasin Albert dhe Edmond Nela nga Kukësi dhe dyshohet se shkak ishte bërë konflikti për trafikun e lëndëve narkotike.

Nga 11 persona për të cilët ishin lëshuar urdhra arresti, u kapën vetëm 5 prej tyre, ndërsa të tjerët rezultojnë të jenë jashtë Shqipërie. Në pranga përfundoi ish zëvendës Drejtori i Policisë së Tiranës Erzen Breçani; drejtuesi aktual i Hetimit të Krimit në Komisariatin 6 në Tiranë Dedan Gjoni; Bujar Gërmizi, një personazh, i cili dyshohet të ketë aktivitet të ndjeshëm në trafikun e drogës, si dhe Besmir Murati, i lidhur ngushtë me Gërmizin.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: arrestohet erzen breçani | Bujar Germizi | Besmir Mustafi | dedan gjoni | albert nela | edmond nela

Komento

Komente

shoqata e ruajtes te kafsheve shwiptare...: 26/11/2023 04:26

futeni brenda e mos e nxirrni me halen..se po na vret faunen my shpellari...//_//_///

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Besoni se vota e emigrantëve do realizohet në zgjedhjet e 2025-ës?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Mero Baze: Ai nuk njihte as baxhanakun

Mero Baze

25 Nëntor, 07:01

Haklaj: Breçani krahu i djathtë i Berishës dhe i majtë i Metës! Korreshi: S'marr pjesë në Këshillin Kombëtar të Rithemelimit

24 Nëntor, 18:48

I dha informacione grupit kriminal për planin për vrasjen e dy vëllezërve, GJKKO konfirmon 'masën detyrim paraqitjeje' për oficeren e drejtorisë së Kufirit, Jonida Babameto

24 Nëntor, 16:20



Doli në përgjimet e 'Sky', SPAK nis hetim pasuror për Elvana Gjatën, Ervin Matën e anëtarët të grupit kriminal! Në 'sitë' edhe pronat e rrethit të afërt familjar

24 Nëntor, 15:17

Kur mohon Erzen Breçanin, imagjino se çfarë mund të bëjë me demokratët e thjeshtë

Namir Lapardhaja

24 Nëntor, 11:54

Dosja e SPAK/ Erzen Breçani dyshohet se investoi 350 mijë euro të trafikut të drogës së djalit në HEC: 'Bush, tan kta në Shqipëri thon djali Erzenit ka bjen mall

24 Nëntor, 07:45

Ylli Pata: 'Daleni, daleni djema se s'i dini të gjitha!' Bumerangu politik i telenovelës kriminale

Ylli Pata

23 Nëntor, 19:23

Dosja e SPAK/ Edhe Nuredin Dumani foli për Erzen Breçanin! Informonte Bujar Ajetin kur policia shkonte ta arrestonte në Kukës

23 Nëntor, 17:22

Përgjimet/ 'Dje nisa punën, keni nga 10 copë', kapja e kokainës në 2020 në Holandë shokon grupin! Dërguesi: Më ka ik zari! Breçani: Na pastë marrë të këqijat

Sokol Dema

23 Nëntor, 16:27

'Mos flet shoferi se gjermanet jan te hidhur shok... Ma shum kena fitu se hum ' Zbardhen përgjimet e shefit të krimeve Dedan GJonit me Albert Prengën për ngarkesën me 166 kg drogë e kapur në Gjermani

23 Nëntor, 10:40

Per vlonjatin...Sa të mbarojë në Ekuador direkt këtu! E kërkojnë Italianët edhe belgët ...." Zbardhen përgjimet e Dedan Gjonit, informator dhe për Dritan Rexhepin

23 Nëntor, 10:37

GJKKO lë në burg Erzen Breçanin dhe 3 pjesëtarët e grupit kriminal/ Breçani: Në burg jam prej djalit, e kam kështillur të mos merret me punë të paligjshme

23 Nëntor, 10:13

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerllumia

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje